

VENDIM
Nr. 273, datë 29.4.2022

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 78, DATË 28.1.2015, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 150/2014, DATË 6.11.2014, PËR PENSIONET
E PUNONJËSVE QË KANË PUNUAR NË MINIERA, NË NËNTOKË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 10, të ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Paragrafi i parë, i pikës 1, të kreut III, të vendimit nr. 78, datë 28.1.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, si më poshtë vijon:

“Në zbatim të nenit 7, të ligjit nr. 150/2014, datë 6.11.2014, pensioni i pleqërisë për punonjësit që kryejnë procese pune në miniera, në nëntokë, jepet me kërkesën e të interesuarit, i cili e paraqet atë së bashku me dokumentacionin përkatës, përmes portalit qeveritar “*e-Albania*”, ndërsa dokumentet shoqëruese dërgohen përmes shërbimit postar pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore ku ka vendbanimin.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj